



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 19.7.2024

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 19.7.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 352, datë 1.3.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të detyrës së lënë në seancën gjyqësore publike të datës 26.6.2024, ku trupi gjykues me shumicë votash, vendosi: [...] *t'i kërkojë Komisionerit Publik të përcaktojë se cilat konkluzione konkrete të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit lidhur me zërat e analizës financiare të subjektit të rivlerësimit kundërshton, sikurse dhe efektin financiar që ato japin në vlerësimin përfundimtar të kësaj analize [...], parashtrijmë si më poshtë:*

Komisioneri Publik, në ankimin e datës 5.5.2021, kundër vendimit nr. 352, datë 1.3.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka kërkuar hetimin e mëtejshëm të çështjes, duke specifikuar, ndër të tjera, nevojën për riçelje hetimi administrativ, pasi në gjendjen që janë aktet, lind nevoja e rivlerësimit të zërave përbërës të analizës financiare të kryer nga Komisioni, duke specifikuar në këtë ankim dhe zërat për të cilët kërkohet rivlerësim nga ana e Kolegjit, konkretisht: (i) kursime të vitit/*cash*, të padepozituara në asnjë bankë; (ii) të ardhura të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe të ardhura të subjektit të rivlerësimit; (iii) shpenzime jetesë për vitin 2007, si dhe (iv) shpenzime udhëtimi, referuar metodologjisë së përdorur nga Kolegji në jurisprudencën e deritanishme.

Kolegji, në raste të ngjashme, ka proceduar me riçeljen e hetimit dhe kryerjen e një analize të re financiare sipas kërkesave të Komisionerit Publik, duke vënë në dispozicion të

palëve pjesëmarrëse në gjykim edhe analizën e detajuar, ku janë reflektuar pretendimet e Komisionerit Publik/subjekteve të rivlerësimit¹.

Thënë kjo, Komisioneri Publik, referuar shkaqeve të ankimit, në vijim të parashtrimeve të datës 26.6.2024 dhe detyrave të lëna nga Kolegji në këtë seancë, paraqet më poshtë argumentimin mbi secilin zë të analizës financiare të kryer nga Komisioni dhe bashkëlidhur, në formë tabelore, efektin e këtyre zërave në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit:

1. *Lidhur me zërin: “Hua në vlerën 30.000 euro”, Komisioneri Publik, pas vlerësimit të prapësimeve të subjektit dhe akteve të depozituara, si dhe në kuadër të evoluimit të jurisprudencës së Kolegjit,² në raste të ngjashme mbi detyrimin e subjekteve në drejtim të verifikimit të mundësisë financiare të huadhënësve, vlerëson se në rastin në fjalë, referuar rrethanave konkrete, mangësitë e konstatuara, trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit lidhur me dokumentimin e plotë të rrethanave faktike për kalimin e shumës së deklaruar si të marrë hua, nuk ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.*

2. *Lidhur me zërin: “Kursime ndër vite”, nga verifikimi i akteve në dosje ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore dorëzuar në ILDKPKI, prej vitit 2005 e në vijim ka deklaruar kursime ndër vite³.*

¹Referohu ankimit kundër vendimit nr. 342, datë 2.2.2021, ankim kundër vendimit nr. 393, datë 3.6.2021, ankimit kundër vendimit nr. 190, datë 26.7.2019, ankimit kundër vendimit nr. 43, datë 18.7.2018, ankimit kundër vendimit nr. 32, datë 5.7.2018, ankimit kundër vendimit nr. 264, datë 17.6.2020.

² Referohuni vendimit (JR), datë 22.5.2024, për s. r. ***, ***, vendimit (JR) nr. 47, dt. 3.11.2023; (JR) nr. 45, dt. 26.10.2023; (JR) nr. 2, dt. 2.2.2023 etj.

³ Në **DV-2005**, subjekti deklaron: [...] Depozitë bankare çelur në tetor 2005, shuma 430.000 lekë, ndërsa në f. 8 të saj deklaron: Depozitë në Bankën *** tetor 2005 [...]. Në **DV-2006**, subjekti deklaron: [...] Depozitë bankare çelur në 2005, që vazhdon të jetë e mbajtur si llogari depozituese vlera në lekë e shtuar për shkak të kësaj llogarie, shuma 30.322 lekë. Me kursimet e vitit 1.258.816 lekë është shlyer një pjesë e huas. Vlera e shtuar dhe njëkohësisht vlera e pakësuar është 1.258.816 lekë [...]. Në **DV-2007**, subjekti deklaron: [...] depozitë Banka *** e çelur në 2005...vlera e shtuar për shkak të kësaj llogarie 21.052 lekë. Me kursimet e vitit në vlerën 977.160 lekë është shlyer një pjesë e huas. Pra, vlera e shtuar dhe njëkohësisht e pakësuar është 977.160 lekë [...]. Në **DV-2008**, subjekti deklaron: [...] depozitë Banka ***, çelur në 2005...vlera e shtuar për shkak të kësaj llogarie 25.000 lekë. Me kursimet e vitit është shlyer një pjesë e huas, e marrë në vitin 2005, 4.000 euro [...]. Në **DV-2009**, subjekti deklaron: [...] depozitë Banka ***, çelur në 2005... vlera e shtuar për shkak të kësaj llogarie 23.000 lekë. Në **DV-2010**, subjekti deklaron: tërheqje të depozitës me afat, në Banka ***, në shumën 550.000 lekë dhe depozitë me afat, në shumën 2.200.000 lekë, dt. *.12.2010, në *** Bank, me burim nga kredia e marrë në ***. Kursime të vitit 2010, në shumën 1.320.000 lekë [...]. Në **DV-2011**, subjekti deklaron: [...] Dhënie huaje me interes 8%...duke prekur depozitën prej 2.200.000 lekë, më *** Bank. Kursime të vitit 2011, në shumën 1.569.000 lekë [...]. Në **DV-2012**, subjekti deklaron: [...] Mbyllje depozite prej 730.300 lekë, në *** Bank... Kursime të vitit 2012, në shumën 530.000 lekë. Në këtë DV deklaron dhe shlyerjen e kredisë pranë *** me burim: (i) hua në shumën 1.500.000 lekë, kthyer nga “***” sh.p.k.; (ii) shuma 730.000 lekë, tërhequr nga *** Bank; (iii) kursimet e vitit 2011, në shumën 1.569.600 lekë (deklaruar vjet); (iv) shuma 252.100 lekë, nga prishja e depozitës, dt. *.5.2012 në *** [...]. Në **DV-2013**, subjekti deklaron: [...] kursime të vitit 2013, në vlerën 2.440.000 lekë, duke specifikuar në seksionin ku kërkohet të depozitohen dokumente justifikues sa vijon: cash, (të padepozituara në asnjë bankë)[...]. Në **DV-2014**, subjekti deklaron: [...] Çelje depozite në emër të bashkëshortit, në *** Bank, në shumën 2.500.000 lekë... Kjo depozitë është çelur nga kursimet e vitit 2013, në shumën 2.440.000 lekë dhe nga të ardhurat e vitit 2014, në shumën 60.000 lekë. Kursime të vitit 2014, në shumën 3.495.000 lekë [...]. Në **DV- 2015**, subjekti deklaron: [...] Çelje depozite në *** Bank, datë *.4.2015, principali 1.600.000 lekë, burimi i krijimit: të ardhurat nga kursimet e vitit 2014. Çelje depozite në *** *** Bank, datë *.4.2015, principali 2.400.000 lekë... nga kursimet e vitit 2014 dhe nga të ardhurat familjare të tremujorit të parë të vitit 2015, në shumën 505.000 lekë... Çelje depozite në ***, principal 1.062.500 lekë me burim: nga pjesa e dividendit që ka përfutuar bashkëshorti nga bilanci i vitit 2014. Kursime të vitit 2015, në vlerën 2.595.000 lekë [...]. Në **DV- 2016**, subjekti deklaron: [...] Çelje depozite kursimi në ***, datë *.10.2016, me principal 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit: kursimet e vitit 2015. Çelje depozite kursimi në *** Bank, në vitin 2016, me principal 800.000 lekë. Burimi: kursimet e vitit 2015. Çelje depozite kursimi në *** ***, vitin 2016, me principal 700.000 lekë. Burimi: kursimet e vitit 2015. Kursime të vitit 2016, në vlerën 1.750.000 lekë [...].

2.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. 4 të Komisionit, lidhur me kursimet, subjekti ka deklaruar se: [...] *Me termin “kursime të vitit” kemi patur parasysht shumën e cash-it (mjete monetare të lira) në banesë me atë në llogaritë tona likuiduese në banka, deri më 31 dhjetor të çdo viti deklarues [...], ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 5 të Komisionit, për kursimet e deklaruara në DV-2013, subjekti ka deklaruar se: [...] Kursimet familjare të vitit 2013 përbëhen nga gjendja e mjeteve monetare të lira cash në banesë dhe mjete monetare të lira në llogaritë likuiduese në banka dhe nuk përfshihen këtu shumat e mjeteve monetare që janë të depozituara në llogari kursime në vitin 2013 ose të depozitave të mbartura. Me shprehjen “të pa depozituara në asnjë bankë” nënkuptojmë që këto mjete monetare janë të lira dhe jo në llogari depozite maturuese për këtë vit, në asnjë bankë [...].*

2.2 Komisioni ka marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ mbi kursimet ndër vite dhe ka llogaritur në analizën financiare ndryshimet, shtesa/pakësime të kursimeve, sipas këtyre pretendimeve. Në analizën financiare diferenca në *cash*⁴ është konsideruar si gjendje të vitit të deklarimit⁵.

2.3 *Komisioneri Publik*, lidhur me kursimet e deklaruara në deklaratat periodike vjetore 2010-2016, vlerëson se pretendimi i subjektit dhe më tej kryerja e analizës financiare nga ana e Komisionit, bazuar në këto pretendime, nuk mbështetet dhe nuk përputhet me mënyrën e deklarimeve të subjektit për vitet 2005-2009, ku subjekti ka deklaruar saktësisht shumat e kursyera dhe vendndodhjen e tyre, në bankë. Në deklaratat periodike vjetore të viteve 2006-2008, subjekti ka deklaruar dhe saktësuar shumën e kursimeve vjetore të shtuara dhe të pakësuara (*si rezultat i shlyerjes së pagesave apo detyrimeve të ndryshme*), ndërsa në deklarimin e vitit 2010 e në vijim, subjekti ka deklaruar shuma të kursimeve, përtej atyre të deklaruara në formën e depozitave bankare, por pa i specifikuar ato nëse janë kursime në *cash* apo llogari rrjedhëse (*deri në vitin 2013*). Ndërkohë, në vitin 2013, subjekti literalisht ka deklaruar se shuma e kursimeve e deklaruar është në formën *cash* [...] *e padepozituar në asnjë bankë* [...]. Pra, në rastin e deklarimit të kursimeve për vitin 2013, duket se subjekti, ndryshe nga vitet e tjera, ka saktësuar mënyrën dhe vendndodhjen e këtyre kursimeve, duke i specifikuar ato si: *cash, të padepozituara në asnjë bankë*.

2.4 Mbështetur dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, mbi mënyrën e llogaritjes së kursimeve të deklaruara nga subjektet në deklaratat periodike vjetore⁶, Komisioneri Publik vlerëson se, më së paku për vitin 2013, kursimet e subjektit dhe personit të lidhur me të, duhet të llogariten sipas deklarimeve në deklaratën periodike të këtij viti, në të cilën specifikohet: [...] *kursime të vitit 2013, në vlerën 2.440.000 lekë* [...] dhe në seksionin ku kërkohet të depozitohen dokumente justifikuese subjekti deklaron: [...] *cash, të padepozituara në asnjë bankë*⁷[...]. Nisur dhe nga paqartësitë/kontradiktat në mënyrën e deklarimit dhe ndarjes midis kursimeve

⁴ Pasi ka zbritur nga totali i kursimeve të deklaruara në deklaratat periodike, shumën e rezultuar në datën 31.12 gjendje në llogaritë rrjedhëse në sistemin bankar, të subjektit dhe personit të lidhur me të.

⁵ Në DV - 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *kursime të vitit 2012, shuma 530.000 lekë* [...]. Komisioni në analizën e kryer ka vlerësuar se kursimet në *cash* të këtij viti, pasi zbriten balancat e gjendjeve në llogaritë bankare, janë në shumën 55.529 lekë, dhe duket se kjo shumë është konsideruar si *cash* i akumuluar i vitit dhe jo si shtesë. Në DV – 2013, subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga deklaratimet e tjera periodike, ka deklaruar: [...] *kursime të vitit 2013, shuma 2.440.000 lekë, “Cash, të padepozituara në asnjë bankë”* [...]. Në analizën financiare të Komisionit, kursimet *cash* të këtij viti janë konsideruar në shumën 777.207 lekë dhe jo sipas deklarimit të subjektit në deklaratën periodike, dhe duket se kjo shumë është konsideruar si *cash* i akumuluar deri në vitin 2013 dhe jo si kursime të krijuara në këtë vit.

⁶ Për më tepër referohuni në vendimit (JR) nr. 11/2019, (JR) nr. 54/2023 etj.

⁷ Ndërkohë, në deklaratimet e mëparshme, në rastet e deklarimit të shumave në depozita bankare, subjekti, në seksionin ku kërkohet të referohen dokumentet justifikuese, ka specifikuar: [...] *nxjerrje llogarie nga Banka* [...].

(në llogaritë bankare dhe në cash) apo dhe identifikimit nëse kursimet *cash* të deklaruara⁸ janë gjendje në fund të vitit apo kursime shtesë të vitit, vlerësohet se pretendimi i subjektit gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 5 të Komisionit, dhe llogaritja e kursimeve të vitit 2013, sipas këtij pretendimi, nuk gjen mbështetje në deklaratën vjetore të vitit 2013, në jurisprudencën e Kolegjit mbi kursimet në *cash*⁹, si dhe në ligjin e zbatueshëm¹⁰. Sa më sipër ndikon në rezultatin financiar të analizës së vitit 2013 (*bashkëlidhur*).

2.5 Edhe marrë në konsideratë ky pretendim i subjektit, duke përfshirë në analizën financiare të vitit 2013 si kursim në *cash* (gjendje) vetëm shumën prej 777.207 lekë (*si diferencë e shumës së kursimeve të deklaruara prej 2.440.000 lekë dhe shumës gjendje në llogaritë rrjedhëse bankare të subjektit dhe personit të lidhur me të, prej 1.662.793 lekë*), përsëri do të rezultonte pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e këtij viti¹¹.

2.6 Sa më sipër do të ndikonte dhe në burimet e depozitës së deklaruar në DV- 2014, në emër të bashkëshortit, në ***, në shumën 2.500.000 lekë, me burim të deklaruar: [...] nga kursimet e vitit 2013, në shumën 2.440.000 lekë¹²[...].

3. Lidhur me zërin “Të ardhura të subjektit dhe bashkëshortit”:

3.1 Mbi të ardhurat e bashkëshortit: Nga verifikimi i akteve në dosje, vlerësohet se informacioni nga institucioni përgjegjës mbi të ardhurat nga pagat dhe honorarët ka mospërputhje, pasi të ardhurat e konfirmuara me shkresën me nr. ***/* prot., datë **.2.2021,

⁸ Pas zbritjes nga shumat e kursyera sipas balancave të llogarive rrjedhëse të subjektit dhe personit të lidhur me të.

⁹ Kolegji (i), në vendimin (JR) nr. 7/2019, është shprehur se: [...] Bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin që, për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen .. si dhe të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike; Në vendimin (JR) nr. 11/2019, Kolegji është shprehur se: Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e tij të deklarimeve të kursimeve në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por edhe pretendim alogjik në kuptim të nocionit të kursimit [...]; (ii) në vendimin (JR) nr. 20/2019 është shprehur se: [...] Në këtë analizë financiare, Kolegji nuk pranoi si të bazuara shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për trajtimin dhe kuptimin e deklarimeve të kryera prej tij. Në analizë të kuadrit ligjor të zbatueshëm për këtë çështje, Kolegji veçon nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, i cili ka parashikuar detyrimin e subjekteve deklaruese në kuptim të atij ligji, sipas përcaktimit që ky ligj kishte në mars të vitit 2012 e në mars të vitit 2014, kohë në të cilën është bërë deklarimi prej subjektit, sipas të cilit: Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjenden deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to; [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj; dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale [...]. Sipas kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i subjekteve deklaruese për të pasqyruar çdo ndryshim të këtyre të drejtave në çdo deklaram periodik. Formulari i deklarimit të pasurisë, i miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, përshkruan më tej mënyrën se si duhen deklaruar këto ndryshime, duke detyruar subjektet të deklarojnë çdo ndryshim (shtesë dhe pakësim) të interesave pasurorë dhe pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme. Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues, të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhin ata mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar [...].

¹⁰ Ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, pavarësisht nga ndryshimet ndër vite, ka pasqyruar detyrimin e subjekteve deklaruese, për të pasqyruar çdo ndryshim të gjendjes *cash* në deklaratat periodike në gjendjen që ishin në 31 dhjetor të vitit të mëparshëm. Konkretisht, në nenin 4 të tij, ky ligj parashikon se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] gjenden deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] (d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

¹¹ Shihni referencën në zërin përkatës të analizës financiare bashkëlidhur.

¹² Referuar vendimit të Kolegjit (JR) nr. 18/2022, prg. 31.2.

nga Universiteti “*** **”, Vlorë, nuk përputhen me aktet e tjera në dosje, si: (i) deklarinimet e subjektit mbi të ardhurat e deklaruara të bashkëshortit në deklaratat periodike vjetore dhe totalin e të ardhurave të deklaruara në Deklaratën “Vetting”; (ii) aktet mbi të ardhurat e bashkëshortit në Universitetin “*** **”, Vlorë, të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI; (iii) listëpagesat e detajuara dhe konfirmimin mbi të ardhurat për honorarët e bashkëshortit¹³, depozituar nga subjekti, bashkëlidhur pyetësorit nr. 3, nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit, duket se të ardhurat sipas kësaj shkrese¹⁴ janë kryesisht kreditime në llogari me përshkrimin: “*dieta udhëtime jashtë shtetit*”, dhe si të tilla vlerësohet se, bazuar dhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit¹⁵, nuk duhet të përfshihen në zërin: *Të ardhura*. Sa më sipër, ndikon në rezultatin financiar të analizës së vitit 2009 dhe 2010.

3.1.1 Po në këtë kontekst, në vlerësimin e Komisionerit Publik, me rezervë, duhet të konsiderohen edhe të ardhurat e konfirmuara në formën e honorarëve për vitin 2005¹⁶.

3.2 Mbi të ardhurat nga qiradhënia e apartamentit të banimit në Tiranë¹⁷ për vitet 2011-2015 dhe të ardhurat nga shitja e librit¹⁸ të bashkëshortit, në vitin 2011, rezultojnë se detyrimet tatimore për këto të ardhura janë paguar në datën 24 janar 2017, nga llogaria e bashkëshortit të subjektit, pranë ***-së. Referuar jurisprudencës së Kolegjit,¹⁹ në raste të ngjashme, vlerësohet se mospagimi i detyrimeve tatimore në kohën e realizimit të tyre, por vetëm në janar të vitit 2017 (rreth 6 vite më pas dhe pak ditë përpara dorëzimit të Deklaratës “Vetting”²⁰), nuk legjitimon këto të ardhura, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për periudhën 2011-2015²¹. Sa më sipër ndikon në rezultatin financiar të analizës së viteve 2011-2015 (*bashkëlidhur këtij akti*).

4. Lidhur me zërin “Shpenzime”:

4.1 Lidhur me “Shpenzimet e jetesës”, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni konstatohet se, për vitin 2007, shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit janë konsideruar jo në përputhje me shkresën nr. *** prot., datë **3.2019, të ILDKPKI-së, si standard i përdorur edhe nga Kolegji në vendimet²² e deritanishme. Sa më sipër ndikon në rezultatin financiar të analizës së vitit 2007.

4.2 Lidhur me “Shpenzimet e udhëtimit”, referuar raportit të hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes së saj, bazuar në metodologjinë e vendimit orientues (JR) nr. 11/2019, datë 22.5.2019, të Kolegjit, si dhe në deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve dhe në deklaratat periodike vjetore, do të rezultonte

¹³ Shkresë nr. **/** prot., datë **.2.2020, të Universitetit “*** **”, Vlorë.

¹⁴ Shkresa nr. **/** prot., datë **.2.2021.

¹⁵ Bazuar në vendimin orientues të Kolegjit (JR) nr. 7/2019.

¹⁶ Referuar shkresave nr. **/** prot., datë **.2.2020 dhe **/** prot., datë **.2.2021, të Universitetit “*** **”, Vlorë, bashkëshorti i subjektit, përveç shumës prej 524.672 lekë, si të ardhura nga paga neto, për vitin 2005, konfirmohet se ka përfituar dhe shumat 296.880 lekë dhe 230.429 lekë, po gjatë vitit 2005, shuma të cilat kanë përmbysur rezultatin negativ të konstatuar nga Komisioni në “Rezultatet e hetimit administrativ”.

¹⁷ Subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore nga viti 2010 e në vijim, përfitimin e të ardhurave nga qiraja, në shumën 50.000 lekë/muaj, në *cash*. Në dosjen e ILDKPKI-së, subjekti ka depozituar kontratë qiraje nr. **/**, datë **.6.2010, nënshkruar mes bashkëshortit të saj dhe shtetasit **/**.

¹⁸ Të ardhura, në shumën 350.000 lekë, kaluar në llogarinë bankare të bashkëshortit, në vitin 2011, të cilat, në janar të vitit 2012, janë kaluar në depozitë bankare.

¹⁹ Vendim i Kolegjit (JR) nr. 15/2021.

²⁰ Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar Deklaratën “Vetting”, në datën 30.1.2017.

²¹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur Deklaratën korrigjuese të të ardhurave (DIVA) të vitit 2011, të kryer në datën **.11.2019, nga bashkëshorti, në të cilën ka deklaruar të ardhura bruto nga qiraja 1.275.000 lekë dhe nga pasuria intelektuale/të drejta ekskluzive në shumën 350.000 lekë, sipas të cilit ka rezultuar një detyrim shtesë tatimor për t’u paguar në shumën 70.000 lekë.

²² Referuar vendimit të Kolegjit (JR) nr. 18/2022, prg. 27.1.

ndryshim i shpenzimeve të llogaritura për udhëtimet e viteve 2006, 2007, 2009, dhe në 2013 (bashkëlidhur këtij akti).

5. Në përfundim, bazuar në sa argumentuar më sipër, bashkëlidhur këtyre parashtrimeve, paraqesim, në mënyrë tabelore, efektin financiar të zërave të mësipërm në vlerësimin përfundimtar të analizës së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 2003-2016.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA